

PROCESVERBAL
nga seanca e 19-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 08.05.2025

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Llazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, Drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Emilija Janevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Goran Radunoviq, Maja Damevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit Lazo Petrushevski, hapi seancën e 19-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në orën 11:00 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Z. Trajçev vuri në dukje se kishte vërejtje në rendin e ditës të propozuar për seancën e 19-të. Ai theksoi se, ndoshta për shkak të gabimi teknik që është përsëritur në disa seanca të fundit, nga rendi i ditës përsëri mungon pika "Të ndryshme".

Z. Petrushevski shpjegoi se ishte në komunikim me shërbimin kompetent dhe se ishte propozuar që pika "Të ndryshme" të përfshihej në rend të ditës vetëm nëse dikush, qoftë nga anëtarët e Këshillit ose nga shërbimi, do të kërkonte përfshirjen e saj. Duke vepruar kështu, është e nevojshme të njoftohet paraprakisht qëllimi për hapjen e pikës nën "Të ndryshme", si dhe tema që do të diskutohet.

Z. Trajçev shprehu pakënaqësi me këtë qasje, duke theksuar se për një kohë të gjatë kishte qenë e padiskutueshme që pika "Të ndryshme" të jetë pjesë përbërëse e rendit të ditës. Ai vuri në dukje se kjo pikë është e pranishme në punën e shumë institucioneve dhe përfaqëson një mekanizëm që u lejon anëtarëve, në çdo kohë të shprehen, të japin propozim, koment ose të nxjerrin në pah ndonjë situatë, pa pasur nevojë paraprakisht të marrin miratimin nga Këshilli. Sipas tij, nëse ndërhyrje të tilla duhet të miratohen paraprakisht për të hyrë në rendin e ditës, kjo përbën kufizim të të drejtave demokratike, imponim të qasjes autokratike dhe krijimin e një sistemi në të cilin anëtarët nuk mund të shprehin lirisht pikëpamjet e tyre. Në këtë drejtim, ai shtoi se nuk sheh arsye pse pika "Të ndryshme" të mos jetë e rregullt në rendin e ditës, edhe nëse rrallë është përdorur në punën e deritanishme.

Z. Petrushevski shtoi se kushdo që ka nevojë, lirisht mund të propozojë përfshirje të pikës "Të ndryshme".

Z. Trajçev vuri në dukje se, nëse kjo pikë nuk përfshihet rregullisht në rendin e ditës të propozuar, ai në të ardhmen do të votojë "abstenim".

Këshilli i Agjencisë, me 5 vota "pro" dhe një abstenim nga z. Trajçev, miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës së 5-të publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 24.04.2025.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës së 18-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 24.04.2025.
3. Propozim - vendim për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Strugës, me Propozim- dokumentacion konkursi dhe Propozim-aplikim.
4. Propozim-vendim për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Shtipit, me Propozim-dokumentacion konkursi dhe Propozim-aplikim.
5. Draft-rregullore për formën dhe përmbajtjen e aplikimit për regjistrim në regjistrin e botuesve të medias online- internet portaleve dhe për mënyrën e udhëheqjes së regjistrit të botuesve të medias dhe mediave online-internet portaleve.
6. Draft-formular për dorëzimin e të dhënave për të siguruar transparencë në punën e botuesve të mediave online – internet portaleve (formulari SUE/2).
7. Propozime për iniciimin e procedurave për heqjen e lejes për transmetim TV të transmetuesve..
8. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 5-të publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 24.04.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 18-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 24.04.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, shpjegoi Propozim-vendimin për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Strugës, me Propozim-dokumentacion konkursi dhe Propozim-aplikim. Ajo vuri në dukje se kjo iniciativë buron nga kërkesë e paraqitur nga palë e interesuar për hapje të radio stacionit lokal në Strugë. Aktualisht, në zonën e komunës ekziston vetëm një radiostacion, i cili transmeton program tërësisht në gjuhën maqedonase. Sipas rezultateve nga Regjistrimi i Popullsisë të vitit 2021, në Strugë jetojnë 50,980 banorë, nga të cilët 50.58% janë shqiptarë, 29.23% maqedonas, 6.81% turq, ndërsa pjesa tjetër janë anëtarë të bashkësive të tjera etnike ose nuk e kanë deklaruar përkatësinë e tyre etnike. Duke pasur parasysh këtë strukturë etnike, është e qartë se ekziston nevoja për program në radio në gjuhën shqipe, në mënyrë që të përmbushen interesat e popullsisë së gjerë. Studimi i fizibilitetit tregoi se ekzistojnë kushte për shpalljen e një konkursi, duke marrë parasysh se në të kaluarën disa radiostacione transmetuan programe në gjuhën shqipe, por disa prej tyre kanë ndërprerë me punë ose u është hequr leja. Në mënyrë që subjekti i ri të ketë kushte më të mira pune dhe akses më të madh për publikun e gjerë, propozohet që programi të transmetohet në dy gjuhësi – në maqedonisht dhe shqip. Në këtë mënyrë, qytetarëve do t'u ofrohet informacion më i mirë dhe do të krijohen kushte më të mira për tërheqjen e reklamuesve, gjë që do të kontribuojë në qëndrueshmërinë ekonomike të radiostacionit.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për shpalljen e konkursit publik për dhënien e 1 (një) leje për transmetim në radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Strugës, dhe përkatësisht për shërbim programor radio folëse-muzikore kryesisht me format informativ të përgjithshëm, në gjuhën shqipe dhe maqedonase, dhe do të transmetohet nëpërmjet radiofrekuence të përcaktuar nga Agjencia për Komunikime Elektronike (AKE), përkatësisht: 104.2 MHz.

Leja do të jepet për një periudhë prej 9 (nëntë) vitesh dhe nuk mund t'i bartet një personi tjetër.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lartpërmendur ta publikon në "Gazetën Zyrtare të RMV-së", në ueb faqen e Agjencisë, dhe në 2 (dy) gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarët të RMV-së, dhe hyn në fuqi nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të RMV-së".

Pika 4

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit mr. Magdalena Davidovska Dovleva, shpjegoi Propozim-vendimin për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Shtipit, me Propozim-dokumentacion konkursi dhe Propozim-aplikim. Ajo vuri në dukje se në Shtip aktualisht transmeton program vetëm një radiostacion, shërbimi programor i të cilit është

radio folëse- muzikore me format të përgjithshëm. Pas dorëzimit të një Kërkesë zyrtare dhe përgatitjes së Studimit, është përcaktuar se ka arsyetim për shpallje të konkursit për radio me format të specializuar-muzikor në gjuhën maqedonase, përmbajtja e të cilit do të përbëhet kryesisht nga muzikë popullore dhe argëtuese. Dhënia e lejes së re do të zgjerohet dhe pasurojë ofertën e radios për qytetarët e Shtipit, duke mundësuar zgjedhje më të madhe të përmbajtjes programore. Stacioni i ri në radio do të transmetojë përmbajtje folëse në vëllim deri në 5% të transmetimit total javor (duke mos llogaritur kohën e rezervuar për përmbajtje të paklasifikuara), dhe së paku 70% nga totali i muzikës së transmetuar javore do të jetë argëtues - domethënë, muzikë popullore. Në Kërkesën e paraqitur është propozuar që pjesa folëse e programit të transmetohet në gjuhën maqedonase dhe serbe. Megjithatë, sipas strukturës demografike të komunës së Shtipit, ku popullsia serbe është një përqindje shumë e vogël, u vlerësua se nuk kishte arsyetim për transmetim në gjuhën serbe. Prandaj, propozohet që programi të transmetohet ekskluzivisht në gjuhën maqedonase. Kriteret për konkurs përcaktohen në pajtim me nenin 74 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, njëjtë si në konkursin e mëparshëm për komunën e Strugës.

Z. Fidanoski shprehu mbështetje për këtë iniciativë. Ai kujtoi se i njëjti aplikant, në njërin nga seancat e mëparshme, kërkoi leje për radio lokale dhe për komunën e Prilepit. Kjo tregon mundësinë e krijimit të një rrjeti radiofonik më të gjerë në të gjithë vendin, nëse aplikanti zgjidhet në konkurs, pasi të gjitha subjektet e interesuara kanë të drejtë të aplikojnë. Ai i uroi suksese në punën e tij të ardhshme dhe shprehu besim se radiostacioni i ri do të kontribuojë në pasurimin e ofertës muzikore në territorin e Maqedonisë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për shpalljen e konkursit publik për dhënien e 1 (një) leje për transmetim në radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Shtipit, për shërbim programor radio muzikore me format të specializuar, në të cilin muzika e transmetuar është kryesisht popullore (argëtuese), në gjuhën maqedonase, dhe do të transmetohet nëpërmjet një frekuence të përcaktuar nga Agjencia për Komunikime Elektronike (AKE), përkatësisht: 105.3 MHz.

Leja do të jepet për një periudhë prej 9 (nëntë) vitesh dhe nuk mund t'i bartet një personi tjetër.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lartpërmendur ta publikon në "Gazetën Zyrtare të RMV-së", dhe në ueb faqen e Agjencisë, dhe së paku në 2 (dy) gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarët të RMV-së, dhe hyn në fuqi nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të RMV-së".

Pikat 5 dhe 6

Z. Petrushevski propozoi që për Pikat 5 dhe 6 të jepet një shpjegim i përbashkët meqenëse kjo është një risi në Ligjin që u miratua së fundmi, dhe më pas për secilën pikë të votohet veçmas.

Këshilli e pranoi propozimin pa kundërshtime.

Z. Trajčevski informoi se me hyrjen në fuqi të ndryshimeve në Ligjin për Media, Agjencia ka detyrim ligjor që në afat prej 30 ditësh të miratojë dokumentet e mëposhtme:

"Rregullore për formën dhe përmbajtjen e aplikimit për regjistrim në regjistrin e botuesve të mediave online – internet portaleve dhe për mënyrën e mbajtjes së regjistrit të botuesve të mediave online – internet portaleve" dhe "Formulari për dorëzimin e të dhënave për sigurimin e transparencës në punën e botuesve të mediave online – internet portaleve (Formulari SUE/2)". Ai theksoi se ka një mospërputhje të vogël midis ligjeve në lidhje me afatet: ndërsa Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV) parashikon një debat publik prej së paku 30 ditësh, ndryshimet në Ligjin për Median imponon detyrim që dokumentet të miratohen në afat prej 30 ditësh. Për shkak të kësaj situate, propozohet që debati publik të zgjasë 15 ditë, pas së cilës më 21 maj do të mbahet një takim në ambientet e Agjencisë, në të cilin ftohen edhe anëtarët e Këshillit. Në takim do të ftohen dhe të gjithë botuesit e internet portaleve, si dhe palët e tjera të interesuara, për të dëgjuar propozime dhe vërejtje, duke marrë parasysh se tashmë po shprehet interes dhe po parashatrohen pyetje në lidhje me ndryshimet e reja. Pas takimit, në 15 ditët e ardhshme, propozimet konstruktive do të shqyrtohen dhe nëse janë të përshtatshme, do të përfshihen në versionin përfundimtar të Rregullores dhe Formularit. Më pas dokumentet do t'i paraqiten Këshillit për miratim.

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, shpjegoi se në pajtim me dispozitat e reja ligjore, Agjencia ka detyrimin të krijojë dhe të mirëmbajë regjistër të mediave online. Ky regjistër do të jetë vullnetar dhe do të mirëmbahet në bazë të aplikimi të paraqitur nga vetë botuesit. Përveç kësaj, Agjencia është e detyruar të përcaktojë formën dhe përmbajtjen e aplikimit, si dhe mënyrën e mbajtjes së vetë regjistrit. Në Draft-rregulloren përcaktohet forma e Aplikimit dhe të dhënat që duhet të përmbajë në mënyrë që të konsiderohet e saktë dhe e plotë. Këto përfshijnë informacione rreth vetë mediumit online, si dhe botuesit të tij. Për më tepër, Ligji parashikon edhe detyrim të ri për mediat online dhe botuesit e tyre. Për të siguruar transparencë në punën e tyre, ata do të duhet, njëjtë si transmetuesit, t'i paraqesin të dhëna Agjencisë mbi strukturën e pronësisë, punën ekonomike dhe kryeredaktorët. Edhe pse ky detyrim iu nënshtrua komenteve nga Agjencia gjatë procesit të përgatitjes së ndryshimeve ligjore, ai është ende i përfshirë në Ligj dhe i rregulluar detajisht përmes aktit të dytë nënligjor - Formularit për paraqitjen e të dhënave për sigurimin e transparencës në punë, i cili do të zbatohet nga subjektet që do të regjistrohen në regjistër.

Z. Petrushevski shprehu mbështetje për të dyja pikat, duke theksuar se ndryshimet në Ligj përfaqësojnë një pasqyrim realist të situatës bashkëkohore, duke pasur parasysh ndikimin në rritje të internet portaleve. Ai kujtoi se gjatë proceseve zgjedhore pati probleme me pagesën e mjeteve financiare ndaj portaleve që u krijuan vetëm për këtë qëllim. Prandaj, këtë iniciativë e konsideron si pozitive dhe me kënaqësi e mbështet. Për më tepër, ai vuri në dukje se gjatë debatit publik dhe takimit të planifikuar me internet portalet dhe palët e tjera të interesuara, nëse dalin propozime konstruktive, ato mund të përdoren për avancim plotësues të përmbajtjeve të akteve nënligjore të propozuara. E njëjta gjë vlen edhe për anëtarët e Këshillit dhe punonjësit e Agjencisë – derisa vazhdon debati publik, ka mjaftueshëm kohë për shkëmbimin e ideve dhe propozime.

Z. Fidanoski deklaroi se do t'i mbështeste të dy draft-dokumentet, duke vënë në dukje se Rregullorja e propozuar përfaqëson finalizimin dhe përfundimin e një procesi që për kohë të gjatë shqyrtohet dhe debatohet në publik. Ai theksoi se është veçanërisht domethënëse që iniciativa për të krijuar një regjistër të mediave online buron nga vetë bashkësia e medias, përkatësisht nga internet portalet. Sipas tij, përfitimet e këtij regjistri janë të shumëfishta. Së pari, do të zgjidhet një dilemë kyçe me të cilën përballen organet e drejtësisë, përkatësisht,

cili subjekt konsiderohet për media, dhe cili jo, sepse deri më tani, në praktikë vlente qëndrimi se çdo gjë që nuk ceket në Ligj nuk njihet si media. Së dyti, do të vendoset një rend i caktuar në kaosin ekzistues në skenën mediatike. Edhe pse zgjidhja nuk është ideale, ai beson se aktualisht përfaqëson një zgjidhje "minimalisht optimale" dhe të pranueshme që do të përmbushë funksionin e saj. Ai gjithashtu vlerësoi pozitivisht faktin se Draft-Rregullorja tregonte mirëkuptim për situatën reale, ku si kusht për regjistrim kërkohen dy punonjës. Sipas tij, ky kriter aktualisht mund të përmbushet nga rreth 30 deri në 40 portale, dhe përveç kësaj, ato më të voglat mund të hyjnë në kategorinë e dytë me një punonjës dhe një të punësuar me kontratë për një periudhë të caktuar. Ai iu referua gjithashtu shfaqjes së të ashtuquajturës "pizhamë gazetari" - domethënë publikimit të lajmeve nga shtëpia, pa strukturë editoriale dhe me qëllim të dyshimtë, e cila shpesh është përdorur për qëllime manipuluese. Ai thekson veçanërisht se krijimi i regjistrimit mund të jetë një "trigger" për ndryshime në Kodin Zgjedhor, në mënyrë që kur të vijë pagesa për reklamën politike zgjedhore, të dihet se kush mund të konkurrojë. Ai përmendi shembuj nga e kaluara ku gjysma e portaleve që morën mjete u themeluan vetëm gjashtë muaj para zgjedhjeve, duke treguar manipulim dhe formim të qëllimshëm. Ai shpreson se me kalimin e kohës, çështje të tilla do të rregullohen më tej dhe do të integrohen në zgjidhjet ligjore. Së fundmi, ai theksoi se rritja e ngarkesës së punës do të kërkojë edhe punësim shtesë në Agjenci, për të cilën pret mbështetje nga përbërja aktuale ose e ardhshme e Këshillit.

Votimi për pikën 5

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Draft-rregulloren mbi formën dhe përmbajtjen e aplikimit për regjistrim në Regjistrin e botuesve të mediave online-internet portaleve dhe mbi mënyrën e mbajtjes së Regjistrit të botuesve të mediave online-internet portaleve, me tekstin e propozuar.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Draft-rregulloren ta publikon në ueb faqen e Agjencisë, me qëllim që të sigurojë debat publik që zgjat 15 ditë, për t'u mundësuar të gjitha palëve të interesuara të shprehin mendimet, pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre.

Votimi për pikën 6

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Draft-rregulloren për formën dhe përmbajtjen e aplikimit për regjistrim në Regjistrin e botuesve të mediave online- internet portaleve dhe për mënyrën e mbajtjes së Regjistrit të botuesve të mediave online-internet portaleve, me tekstin e propozuar.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Draft-rregulloren e lartpërmendur ta publikon në ueb faqen e Agjencisë, me qëllim që të sigurojë debat publik që zgjat 15 ditë, për t'u mundësuar të gjithë palëve të interesuara të shprehin mendimet, pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre.

Pika 7

Z. Trajçevski shpjegoi propozimin për inicim të procedurës për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV Shenja SHPKNJP Shkup. Ai

informoi se transmetuesi nuk e kishte paguar në kohë kompensimin vjetor të lejes për transmetim, prandaj propozohet fillimi i procedurës për heqjen e lejes. Për më tepër, ai raportoi se në komunikim me drejtorin e transmetuesit, mori konfirmim se mjetet do të paguheshin në kuadër të afatit shtesë prej 15 ditësh.

Këshilli i Agjencisë njëzëri inicioi procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV SHENJA SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-778 datë 07.09.2023, për shkak të mospërmblidhjes së detyrimit. nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, përkatësisht nuk ka paguar kompensimin e lejes për transmetim televiziv Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sipas faturës së dorëzuar nr. 2025-100-0129 datë 04.07.2025.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciim të procedurës për heqjen e lejes, do miratojë Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV SHENJA SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-778 datë 07.09.2023, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

Pika 8

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore, mr. Emilija Janevska, shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media. Ajo shpjegoi se në gjysmën e dytë të marsit, kur sektori realizoi disa mbikëqyrje kontrolli për respektimin e detyrimeve të LSHMAAV, është konstatuar se transmetuesi kishte shkelur nenin 14 të Ligjit për Media. Prandaj, u përgatit një Raport mbi mbikëqyrjen e jashtëzakonshme administrative, të kryer sipas detyrës zyrtare. Gjatë kontrollit më 25 mars, është konstatuar se në disa pjesë të përmbajtjes së transmetuar atë ditë, nuk ishin publikuar të dhëna për impresium. Për këtë arsye, propozohet shqiptimi i masës vërejtje publike me afat prej 20 ditësh për përmbushjen e detyrimeve, pas së cilës do të kryhet mbikëqyrje kontrolli. Ajo gjithashtu informoi se transmetuesi pas skadimit të afatit për deklaram dorëzoi shkresë se shkelja është mënjeluar.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim mbi mbikëqyrjen e jashtëzakonshme administrative sipas detyrës zyrtare, mbikëqyrje administrative, nr.10-1555/1 datë 01.04.2025 dhe njëzëri konkludoi që SHTR DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar t'i shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media, sepse më 25 mars 2025 nuk ka publikuar impresium në: programet me përmbajtje fetare " Rregulloret e shkurorizimit në islam", lexim nga Kurani (i plotë audiovizual pa titull), "Drita Islami dhe "Besimi në Allahun xh.sh. dhe shpresa"; programi dokumentar-argëtues "Kuzhina në ekran" dhe në emisionin informativ reprizë-intervistë me Ardian Hoxhën, drejtor i "Albafon" "Emision debativ" - Meqë ra fjala".

Në pajtim me pikën 7 të Udhëzimeve për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat e Ligjit për Media.

Sektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë Aktvendim për shqiptim të masës vërejtje publike për transmetuesin e lartpërmendur.

Sektori për çështje programore, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për vërejtje publike të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk veproi).

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**